# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443340**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Intervista në Syri Tv - Mbipopullimi në shkollat e Tiranës/ Lamaj: Investime të pabarabarta në arsim, po shpopullohen periferitë |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/916574/mbipopullimi-ne-shkollat-e-tiranes-lamaj-investime-te-pabarabarta-ne-arsim-po-shpopullohen-periferite/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 13:59:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 13:30:20 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 1aec64488f37e7de805235b421e5d314ee912caa8398d3e07ecfa4d50cd6a147 |
| TEKSTI | 36267f039d889461c9ce21471c294b46be0dd10bdee5748fadd353f912a63b29 |
| PAMJA | 6cd3d4db7eb18195a1b6146aaa94817873a6d80c234a24a0fd923768c127746a |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | b14caa8f79d92e949698090d36a7b347525ae7b8a9868d75b1f44d197c95dc00 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 6e410cf6c3be6bd40f75161c1288a8066fcd1b6e7ab80a3c789507dd842f2954 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b14caa8f79d92e949698090d36a7b347525ae7b8a9868d75b1f44d197c95dc00`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

syri



IRENA BEQIRAJ
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA
Dialog me mbesën

# Mbipopullimi në shkollat e Tiranës/ Lamaj: Investime të pabarabarta në arsim, po shpopullohen periferitë

15:30, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

+ A - 

**Me nisjen e vitit të ri shkollor ka dalë në pah një krizë e thellë dhe një pabarazi ekstreme në sistemin arsimor shqiptar.**

Ndërsa shkollat e zonave rurale dhe periferike po mbyllen ose po bashkojnë klasat për shkak të mungesës së nxënësve, institucionet arsimore në qendrat urbane po përballen me një mbipopullim të paprecedentë, duke e kthyer procesin mësimor në një sfidë të vërtetë për cilësinë.

Në një intervistë për edicionin e mesditës në Syri Tv, Alma Lamaj nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit tha se mbipopullim nuk i shërben as nxënësve, as mësuesve dhe zhduk plotësisht thelbin e cilësisë në mësimdhënie.

Sipas saj, arsyeja kryesore pas këtij kaosi lidhet drejtpërdrejt me investimet e pabarabarta në infrastrukturën shkollore, ku prindërit po braktisin shkollat periferike, të cilat prej vitesh ofrojnë më pak mundësi dhe kushte, duke kërkuar më të mirën për fëmijët e tyre në zonat urbane.

Nga ana tjetër, theksoi Lamaj, periferitë dhe zonat rurale po përjetojnë braktisje masive si pasojë e emigracionit, rënies së lindshmërisë dhe lëvizjeve demografike drejt qyteteve të mëdha.

> *Më bën përshtypje, është pak të thuash. Unë jam shumë e shqetësuar me situatat që ndodhin, por kemi një panoramë të ndryshme në fakt në periferi dhe në qendër. Po kjo nuk ndodh vetëm në Tiranë. Pa dyshim s'kanë faj në një farë mënyre, sepse secili prind kërkon më të mirën për fëmijën e vet apo jo? Pra, kemi një problem, tani të kthehemi te shkaku. Ne kemi investime të pabarabarta në arsim. Dhe prindërit me të drejtë kërkojnë t'i regjistrojnë fëmijët pranë shkollave që në fakt u bë disa vite që po trajtohen si shkolla më të mira, dhe në periferi si shkolla më pak të mira, ose shkolla që ofrojnë më shumë mundësi dhe shkolla që ofrojnë më pak mundësi.*
>
> *Këtu flasim për investime infrastrukturore që i bëhen shkollave. Pra kur them s'ka investime të barabarta, ky është fakt, që një shkollë që ndodhet në mes ose në qendër të Tiranës me një shkollë që ndodhet në periferi të Tiranës apo në qarkun e Tiranës. Këto gjëra kanë sjellë*

më të lexuarat

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtsisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rrimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

*në periferi të Tiranës apo në qarkun e Tiranës. Këto gjëra kanë sjellë problematika edhe këtu, pra dhe në mes të Tiranës ne kemi probleme. Unë sot po përballem me shkollën "Kosova", nga klasa e parë në klasën e nëntë i kemi 38 fëmijë në klasë të parë, në klasë të nëntë, pra një klasë me 38 nxënës. Ka rëndësi cilësia. Kujt i shërben? I shërben nxënësve? Jo. I shërben mësuesve? Jo. I shërben cilësisë? Jo. Atëherë përse i mbipopullojmë disa shkolla? Kemi "Gustav Mayer", po kështu numri është shumë i madh në klasa. Kemi klasat e dhjeta në katër gjimnazet e qendrës të Tiranës, po kështu është situata. Po jo vetëm thashë në Tiranë.*

*Jo më pak larg se mbrëmë, zonja që përfaqëson Sarandën më tha të njëjtën situatë edhe në qytetin e tyre. Që ne kemi vite që e themi, po mungojnë nxënësit, po rinia po largohet. Ndërkohë jemi dhe përballë këtij fenomeni ku ne na transferohet lëvizja, pra përqendrohet kërkesa për t'i mësuar fëmijët pranë shkollave të cilat tashmë le t'i themi quhen "elitë", dhe shkolla më pak të investuara në periferi të secilit qytet. Patjetër që është shqetësim dhe ajo që u vu re në muajt e fundit, pra po flasim në muajin gusht, një udhëzim që bëri disa ndryshime të udhëzimit për menaxhimin e normave të punës mësimore dhe numrit të nxënësve në klasa. Ky është udhëzimi numër 16 që i përket gushtit të 2024-ës, bëri disa ndryshime të udhëzimit 14 që i përket 2023-shit. Ky udhëzim në fakt nuk prodhoi cilësi, po prodhoi një mënyrë për të menaxhuar nxënësit dhe shkollat në zonat rurale.*

*Ky udhëzim në fakt, unë i kam sjellë edhe se kemi bërë edhe një analizë. Atëherë ne jemi në një situatë ku në fakt po menaxhojmë shkollat është ulur numri i nxënësve për shkollën që menaxhojnë drejtuesit, po flasim në shkollat periferike. Është ulur numri i nxënësve në klasat e bashkuara. Pra tashmë do të kemi tre klasa të bashkuara që do të jenë, jo nga e para në të pestën në një klasë nxënësit, por duke ulur numrin e nxënësve, 11 është pragu, do të kemi domethënë klasa të bashkuara me numër 11 deri në 30, mos gaboj se me shifrat dua të jem korrekte. Klasat e bashkuara bëhet fjalë për nga e para në të dymbëdhjetën krijohen klasat e bashkuara, po kryesisht në këto momente ne jemi te klasat 1-9. Tani udhëzimi solli ndryshime se si të menaxhohet kjo situatë. Pra udhëzimi solli këtë mënyrë përmirësimi duke ulur numrin, pra po themi 21-30 nxënës do të organizohen në tre klasa. Pra 21 nxënës, klasa e parë, e dytë, e tretë në një shkollë të periferisë, në një shkollë fshati, rurale.*

© SYRI.net

Lexo edhe:


Tabaku: Afera KAYO godet procesin e integrimit, "sistemi Rama" po pengon të ardhmen europiane të Shqipërisë


Seanca në Gjykatën e Lartë/ Nuk gjykohet kryebashkiaku, por individi Erion Veliaj, i akuzuar për korrupsion


Babëzia e Ramës si origjinë e krizës së pagave me gjyqtarët

'Po blejnë influencë te zyrtarët e BE', Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës

SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin e tyre

'Diaspora nuk ka për tia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto

TË NGJASHME

Apeli i GJKKO-së pranon kërkesën e Metës: Do gjykohet jashtë kafazit të qelqtë

Mazhoranca refuzon përfshirjen në kalendar të nismës për shfuqizimin e 'Ligjit për Zonat e Mbrojtura'- Zhupa: Po mbroni korrupsionin

SYRI TV/ Sterilizimi/ Lufta brenda qeverisë e hapur, tenderi u fitua pa garë nga 'Diaverum'

PD: Viti i ri shkollor nis me 4 mashtrime nga qeveria, arsimi shqiptar në gjendje të rëndë dhe jashtë çdo standardi

Blushi: S'është problem paga e

A do mbushet bregdeti i Semanit me

A do e lëshojë Rama, Ballukun?

gjyqtarit, por korrupsioni dhe 16 miliardë euro që s’futen në buxhet

parqe foto voltaike? Subashi i Fierit hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë

Berisha: Ka një tension real midis tyre pas arrestimit të Agasit

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.